

Avni Avdiu, PhD¹

UDC: 37.014.525
37.016:3]:28

**RËNDËSIA E LËNDËVE NATYRORE DHE SHOQËRORE NË
KURIKULAT E MEDRESEVE**

**ЗНАЧЕЊЕТО НА ПРИРОДНИТЕ И ОПШТЕСТВЕНИТЕ
ПРЕДМЕТИ ВО НАСТАВНИТЕ ПРОГРАМИ НА МЕДРЕСИТЕ**

**THE IMPORTANCE OF NATURAL AND SOCIAL
SUBJECTS IN MADRASA CURRICULA**

Abstract

Whenever we talk about religious discourse, it is just as often necessary to reiterate the importance and necessity of natural and social subjects in madrasa curricula. The paradox of this issue lies in the fact that everyone accepts their need and importance and at the same time it seems that it has become a formality, because in a way practically this is not taken into account enough. It is natural for religious subjects to have priority in madrasas, but it is unreasonable for other subjects to be considered second-rate and third-rate. It is also worth noting that the weight of natural subjects is just as valuable as that of social ones. In this sense, every madrasa student should have the general culture of understanding planted in them that without knowledge of natural and social subjects' knowledge of religious subjects is incomplete.

The methodology of the approach of this study is research, analytical and comparative, where the books that discuss this issue, textbooks and some lessons of imams are taken as proof. Through these

¹ Ligjërues në UNT-Shkup, PHD në filozofi dhe PHD në sociologji. Email: avni.avdiu@unt.edu.mk

three study elements, it is desired to highlight the role, need, importance and necessity of natural and social subjects in the curricula of the madrasa, as well as the lack of seriousness of their approach in a deeper way. Meanwhile, the expectations of this study are to encourage, provoke and promote deeper research in this regard, but also to justify, argue and raise the level of adequate treatment of these subjects in the future in the curricula of madrasa education.

Keywords: natural and social sciences, education, textbooks, madrasa

1. ‘Lufta’ për diploma të pranueshme

Ideja ime lidhur me këtë temë, njëherësh ka qenë edhe preokupimi im i kahershëm. Pra fillimisht unë kam pasur vetëm dyshim, supozim dhe dilemë, kurse më pas të gjitha këto më janë shndërruar në bindje. Për këtë bindje të fituar, unë pretendoj se kam prova, të cilat do të mundohem t’i elaboroj.

Është fakt dëshpërues se diplomat e medreseve në disa universitete shtetërore kontestohen dhe madje nuk pranohet regjistrimi i nxënësve me to. Vjet vetë personalisht isha në komision regjistrimi dhe kishim urdhër nga Ministria e Arsimit të Maqedonisë që të mos pranohen. Edhe Medreseja në Preshevë, doli po ashtu me një komunikatë ku shpreh këtë shqetësim. Për këtë konsideroj se duhet të ndizet alarmi i gjithanshëm nga të gjitha strukturat e bashkësive islame shqiptare në Ballkan, për t’u kërkuar shkaqet dhe për t’u punuar në drejtim të zgjidhjes së këtij problemi. Unë mendoj se kjo para së gjithash e për më tepër është tendencioze, sepse edhe shkollat e mesme laike janë në krizë të thellë për nga cilësia e arsimit. Mirëpo ka hapësirë dhe mundësi që medresetë me sistemin e tyre edukativo-arsimor dhe me kurikula cilësore, ta rrëzojnë këtë alibi që është ndërtuar qëllimisht. Për t’u arrirë kjo unë mendoj se ka nevojë imediate dhe është e patjetërsueshme që të hartohet një strategji e përgjithshme unike e një programi të përbashkët të avancuar arsimor në medrese.

2. Medreseja është më shumë se një shkollë

Duket se në opinion vlerësimi për medresenë nuk është ashtu siç e meriton. Nga ana tjetër, për shumë aspekte ajo është shumë më e

avancuar se çdo shkollë e mesme. Madje medreseja i ka të gjitha predispozitat që të jetë shumë më përpara, si në kushtet që ofron, si në disiplinën që ka, por pse jo edhe cilësinë në mësimdhënie. “Medreseja si institucion është më shumë se një shkollë ku mësohet dituria ose njohuri të ndryshme profesionale... Medresanti duhet të krijojë bindjen se përfitimi i njohurive, shkathtësive dhe shprehive nga fusha islame dhe fusha të tjera të shkencës, janë mjeti që ai duhet të arrijë qëllimin e planifikuar... Ndërkaq medreseja si një institucion edukativo-arsimor duhet të japë rezultatet me sa vijon: zhvillimin e aftësive mendore, psikike dhe fizike të nxënësve, aftësimin e tyre për të përdorur gjuhë të huaja, aftësimin për të vazhduar shkollimin e tyre në institucione të arsimit të lartë në vendin tonë dhe jashtë, aftësimin për përdorimin e burimeve të ndryshme të informacionit për kërkime të pavarura, ngjalljen e interesimit të nxënësve për njohuri të reja shkencore, zgjimin e vetëdijes krijuese, të menduarit kritik dhe ndjenjën për angazhimet në punë... ndërgjegjësimin për përkatësinë kulturore... ngritjen e kulturës ekologjike...” (etj.).²

3. I domosdoshëm një rifreskim në qasje

Nga fidbeku dhe njohuritë e fituara të medresantëve, rezulton se shkencat natyrore kanë një status sekondar, ndërsa ato shoqërore një status terciar. Prioritet mbi prioritete u jepet lëndëve fetare.

Mirëpo kjo qasje mund e duhet të ndryshojë, edhe atë pa u cenuar prioriteti. Ndërkaq, kjo mund të arrihet vetëm duke nxitur vazhdimisht afinitetet e secilit nxënës veç e veç, për ato lëndë që secili prej tyre ka më së shumti talent. Motivimi duhet ta rrjedhë prej çdo mësimdhënësi, ndërsa secili mësimdhënës përkatës e di dhe mund ta vlerësojë se kush për çfarë shquhet më shumë. Duke qenë secili mësimdhënës aktiv, jo vetëm në mësimdhënie, por edhe në motivimin dhe nxitjeve e nxënësve më të dalluar në lëndët përkatëse, ai në mënyrë të vazhdueshme përgatit kuadro që ka gjasa të përcaktohen më tutje madje jo vetëm në studimin e fesë, por edhe në studimin e ndonjë lënde prej shkencave natyrore ose shoqërore. Tekefundit, nxitja e motivimi për vlefshmërinë e lëndëve natyrore e shkencore, mund të arrihet edhe me organizimin e kuizeve dhe shpërblimeve të ndryshme nga ana e drejtorisë.

² Nesimi, Qani, *Medreseja Isa Beu si rivendosjen e traditës arsimore institucionale islame*, Hëna e Re, viti XXX, nr.314, Shkup, nëntor 2017, f.18, 21.

Nisur nga ky fakt, nxënësit në medrese nuk do t'i anashkalojnë lëndët natyrore e shoqërore, por do t'i merrnin me të njëjtin interesim e vullnet sikurse lëndët fetare. Si pasojë e mospërfilljes sa duhet të lëndëve natyrore e shoqërore, kuadrot e medreseve kanë gjithnjë e më pak njohuri të etabluara nga këto shkenca. Më pas kjo kulturë arsimimi reflektohet edhe në edukimin e lartë dhe rrjedhimisht diplomojnë kuadro predikuesish me njohuri të pakta nga lëndët natyrore e shoqërore, gjë që pasqyrohet qartazi në diskursin e ligjëritimit teologjik.

“Stagnimi i gjatë i mendjes së muslimanëve ua ka bërë shprehi atyre që të mendojnë në abstraksion nga veprimi dhe të veprojnë në abstraksion nga mendimi. Për këtë shkak, dijetarët muslimanë për së tepërmi e kanë preokupuar veten me realitetet normative, ndërsa pak ia kanë vënë veshin atyre empirike të kohës. Për një kohë të gjatë ata e kanë kënaqur vetveten, duke medituar rreth fenomeneve pas ngjarjes së tyre, në vend që t'i parashikojnë dhe të përgatiten për to”³.

4. Halo-efekti dhe defekti

Konsideroj se shkencat natyrore e shoqërore duhet të kenë trajtim më serioz në nxënie. Në këtë kuptim të gjithë mësimdhënësit herë-herë duhet të flasin në atë drejtim se lëndët e tjera janë po aq të vlefshme e të çmueshme si lëndët e mësimin të fesë.

Më kot është i shkëlqyeshëm një nxënës në lëndët fetare, nëse është i dobët në lëndët e shkencave natyrore e shoqërore. Edhe më keq krijohet iluzioni kur mësimdhënësit e medresesë nën ndikimin e ‘halo-efektit’ të notave të shkëlqyeshme të nxënësit në lëndët e mësimin të fesë, vlerësim të njëjtë bëjnë edhe në lëndët e tjera, me arsyetimin e mosprishjes së suksesit. Në këtë mënyrë, nxënësit motivohen, nxiten dhe inkurajohen të fokusohen më shumë vetëm në lëndët fetare, duke marginalizuar lëndët e tjera.

“... Është e vështirë për një student musliman të rritur dhe në sistemin gjysmëtradicional islam të arsimimit, pa folur për medresenë klasike - të kuptojë se si është ndarë mësimdhënia e degëve të ndryshme të dijes nga vlerat fetare në arsimimin modern”. Tashmë ekziston ndarja mes shkencave natyrore e matematikore nga njëra anë dhe shkencave shoqërore e së fundmi humane nga tjetra, ku secila ka perspektiva dhe metoda të ndryshme, ndërkohë që në rastin e shumë ushtruesve të këtyre

³ Faruki, Ismail, R., *Islimizimi i diturisë*, Mehmed Akif Ersoji, Shkup, 1992, f.84.

disiplinave të fundit ekziston përpjekja për të emituar shkencat natyrore”... Prandaj, është tejet kritike në një kohë kur muslimanëve u duhet të mësojnë disiplina të ndryshme perëndimore, përfshirë jo vetëm shkencën e teknologjinë, por edhe të tjera, për të qenë në gjendje të sigurojnë përgjigjet e tyre dhe të marrin në duar fatet e tyre në një botë me sfida të pamatura, që të bëhen plotësisht të vetëdijshëm për kuptimin, rolin dhe funksionin e arsimit dhe institucioneve arsimore, përfshi sidomos filozofitë që qëndrojnë pas tyre. Në këtë mënyrë, ata mund të aftësohen të mësojnë sa të jetë e mundur atë që dëshirojnë të mësojnë nga disiplinat perëndimore, pa u ndotur së tepërmi në mënyrë të pavetëdijshme nga forca që mund t’ua shtrembërojnë perspektivën fetare, t’i çrrënjosin shpirtërisht dhe intelektualisht, t’i tëhuajsojnë nga sfondi i tyre tradicional dhe thjeshtë t’i shtojnë një tjetër element të fuqishëm rritjes së çrregullisë dhe kaosit brenda vetë shoqërisë islame”⁴.

Përderisa kohëve të fundit në përdorim ka hyrë shprehja ‘analfabet funksional’ me të cilin përshkruhet gjendja e të diplomuarve të padijshëm në shkencat laike, në rastin konkret konsideroj se punohet për thirrës-davetxhinj gjysmëanalfabet, sepse anashkalimi i shkencave në të gjitha nivelet e arsimit nga davetxhinjtë e ardhshëm krijon probleme të mëdha e të rënda në misionin e shenjtë.

Mendoj dhe fuqishëm besoj se davetxhiu duhet të jetë një enciklopedi e gjallë e pothuajse të gjitha shkencave natyrore dhe shoqërore.

Ai në dritën e besimit duhet t’i shohë “... shkencat dhe ligjet e natyrës, të krijesave në tokë e dete. Mbi këtë bazë duhet të ndërtojë vëzhgimin e botës së gjallë, të bëjë eksperimente dhe të vërtetojë se asgjë nuk krijohet në mënyrë të rastësishme”⁵.

5. Mision që kërkon plotësi në profesion

Duke grumbulluar e pasur njohuri të gjithanshme, e jo vetëm fetare, por nga të gjitha dijet natyrore e shoqërore, nxënësi i medresesë i jep kuptim të plotë profesionit të vet.

E për t’u arrirë kjo, duhet të krijohet shprehia që në bankat e medresesë, ashtu që të mbillet dëshira, dashuria dhe vullneti për të gjitha shkencat natyrore e shoqërore. Mbi të gjitha e para së gjithash duhet të jetë kuadri

⁴ Nasr, Sejjid, H., *Arsimi modern, historia, teoritë dhe filozofitë e tij*, Logos, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2011, ff.11,14,19,20.

⁵ Daliu, Ibrahim, Hafëz, *Vlerësimi i diturisë sipas fesë islame*, DI-Dituria Islame, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, viti XXIV, nr.8, gusht 2015, f.21.

cilësor që i stimulon në këtë drejtim. Secili në lëndën e vet, duhet të flasë edhe për rëndësinë e lëndës përkatëse, edhe atë duke filluar nga mësimdhënësit e gjuhës shqipe. Është fakt se pjesa dërrmuese jo vetëm e medresantëve, por edhe e predikuesve me arsimim superior fetar, bëjnë gabime elementare gjuhësore, trashanike e të pajustificueshme. Tashmë kur çdo postim ose ligjërim shpejt bëhet viral, është e dëmshme kur shihet se medresanti ose hoxha përdor mbi 20% fjalë arkaike, barbarizma sllave e turke, duke pasur fjalë shqipe, pastaj edhe shumë gabime të tjera gramatikore. Kjo ndikon negativisht në perceptimin e opinionit. Sa herë them medresanti, kam parasysh hoxhën e ardhshëm.

“Nuk ka nxitje më të madhe, për gjallërimin e besimit tonë, se që janë të vërtetat e shpallura nga shkenca. Këta janë pikërisht ata tregues, drejt të cilëve Kurani vazhdimisht e tërheq vëmendjen tonë”⁶.

6. Mosnjohuria e shkencave e bën ligjëruesin qesharak

Medresanti duhet ta dijë në njëfarë niveli të kënaqshëm edhe biologjinë, sepse si do të flasë nesër ai për rëndësinë e jetës, krijesave, trupit-organizmit, shëndetit etj... pa këto njohuri elementare. Ai duhet ta njoh deri-diku po ashtu edhe gjeografinë ose astronominë sepse në ligjërimet e tij ai do të duhet të flasë për tokën, ujërat, trupat qiellor etj., e për të cilat ka ajete e hadithe. Si do t’i interpretojë ai ato, pa njohuri për to. Sa për ilustrim vlen të shkëputet një fragment prej një ligjërate fetare ku hoxha thoshte: “U ka thënë Pejgamberi a.s. mushkrikëve se sikur të më vendosen dy planetet më të mëdha Dielli në njërin krah, e Hëna në krahun tjetër, unë nuk zmbropsem nga kjo rrugë”. Pra, nga kjo kuptohet se hoxha nuk posedonte as njohuri të një nxënësi të klasës së 6 fillore nga gjeografia ose astronomia, pra nuk e di se këto nuk janë fare planete, se Dielli është ylli më i madh i galaktikës sonë, kurse Hëna është satelit i Tokës. Kur ai thotë se këtë e ka thënë Pejgamberi, e komprometon madje edhe atë tek ata që nuk interesohen të shkojnë te burimi i hadithit në origjinal. Mos të harrojmë se xhamitë frekuentohen nga intelektualë të profileve të ndryshme, e të dëgjojnë këso farë ligjëratash, është mjaft për keqardhje.

Medresanti duhet të dijë edhe njohuri nga historia, të mos i ngatërrojë periudhat, ngjarjet e mëdha dhe personalitetet e famshme. Po ashtu ai sadopak duhet të ketë njohuri nga fizika.

⁶ Mewdudi, *Studentët muslimanë*, LRI, Shkup, 1991, f.2.

“Neve na është urdhëruar ta studiojmë botën fizike për t’iu afruar Allahut të Madhëruar (përmes shenjave në natyrë)...”⁷.

Medresanti duhet të ketë njohuri edhe nga kimia. “Kimia si shkencë natyrore është shumë atraktive dhe me rëndësi të veçantë, sepse ajo studion nga aspekti kimik materien, botën materiale, lëndët e ndryshme që i përdorin në jetën e përditshme, të gjitha ato të mira materiale që na i ka falë Zoti Madhërishtëm në Tokë dhe në Gjithësi”⁸.

Medresanti duhet të ketë njohuri nga matematika dhe informatika. Në kohën e shoqërisë informative, ku të dhënat kompjuterike janë bërë oksigjen i zhvillimit tekniko-teknologjik me aplikim që nga bujqësia e komunikacioni e gjer te mjekësia e astronautika, është vërtet për keqardhje që medresanti të mos i dijë operacionet më të thjeshta kompjuterike.

Krahas shkencave natyrore, medresanti duhet të njohë edhe shkencat shoqërore.

“Kulturën, njohuritë dhe edukatën e tij studenti e plotëson me anë të: mësimëve dhe leksioneve të përgjithshme... librave që kanë për qëllim të ndërtojnë një vizion të saktë lidhur me aspektin e parimeve të besimit, politikës, ekonomisë, atë shoqërore e shkencore si dhe lehtësimin e përvetësimit të tyre nga masa e studentëve”⁹.

Ai duhet ta dijë filozofinë dhe logjikën. Problematikat e ndryshme ontologjike, epistemologjike, gnosologjike, estetike, etike e të tjera që derivojnë nga filozofia, janë boshti oscilues rreth të cilit sillen çështjet e përditshmërisë dhe pa kuptimin e koncepteve bazë nga këto lëmi është zor të përfshihen në çfarëdo qoftë diskursi intelektual e akademik.

Po ashtu medresanti duhet ta njohë psikologjinë me të mirat e të këqijat që mësohen prej saj. Ai duhet t’i kuptojë të metat e teorisë frojdiane dhe pasojat e saj, e të flasë me argumente islame kundrejt tyre. Mirëpo ai duhet t’i mësojë edhe njohuritë e vlefshme të psikologjisë, ngase në të ardhmen ai pritët të ketë punë me individ e grupe dhe mosnjohja e kësaj lëmie do të ishte po ashtu një handicap në përcimin e mesazhit që synon ta përcjell. Kjo, ngaqë ai duhet t’u flasë njerëzve sipas mentalitetit të tyre.

⁷ Golshani, Mehdi, *Filozofia e shkencës: një perspektivë kuranore*, Mejdani, viti II, nr. 6, prill-qershor 2018, Gnosa, Tetovë, f.23.

⁸ Kamberi, Bedri, [Dr.chem. sci. profesor i UP dhe UT], *Zoti e bekoftë rininë tonë shkollorë*, Argumenti, viti I, nr.6, 2002, f.26.

⁹ Tahhan, Mustafa, M., *Udhëzues për veprimtari studentore*, Furkan ISM, Shkup, 2005, f.39.

Gjithashtu medresanti duhet ta njohë sociologjinë, ngase problemet, të cilat i trajton ajo, në veçanti sociopatologjia janë preokupim edhe i Islamit. Duke njohur sociologjinë ai e njeh më mirë strukturën dhe dinamikën e shoqërisë, grupeve, shtetit, ligjeve etj.

Njëherësh kupton impenjimin e teorisë darviniane në fashizëm, komunizëm dhe neoliberalizëm dhe u kundërvihet këtyre rrymave ideologjike me argumentet e Kuranit dhe hadithit.

7. Dashuri e pasion për çdo dije

Shkurt e thjesht, medresanti duhet t'i dojë shkencat natyrore e shoqërore me plot pasion dhe t'i mësojë ato me vullnet të plotë. Nxitje për këtë janë shumë ajete kuranore që e inkurajojnë t'i shqyrtojë aspektet empirike që nga vetja jonë e deri te hapësirat e pafundme kozmike.

“Vlerësimi i Islamit për dijen është akoma më i madh se për njeriun që përkushtohet vetëm në adhurim”¹⁰.

“Civilizimi perëndimor ka dhënë kontribut të çmuar në zhvillimin e shkencës. Mirëpo të njëjtën gjë e kanë bërë edhe shumë kultura të tjera”¹¹.

“Bota islame krijoi universitetet e para, madje edhe spitalet e para në botë. Ky fakt mund të jetë krejtësisht i papritur për perëndimorët, të cilët zakonisht kanë një pasqyrë tjetër të Islamit në mendimet e tyre”¹².

“Nuk ka pavarësi të mirëfilltë pa aftësi që vetë t'i aplikojmë dhe t'i përdorim të arriturat e shkencës dhe që këto të arritura më tej t'i përparojmë... Nuk është pra pyetja në atë se a do ta pranojmë apo jo shkencën dhe teknikën - sepse do të detyrohemi t'i pranojmë nëse duam të ekzistojmë, - por a do ta bëjmë këtë kreativisht apo mekanikisht, me dinjitet apo inferioritet... Duke i pasur parasysh këto fakte, me siguri të plotë mundemi të deklarojmë se sistemi shkollor në botën e sotme muslimane është institucion, i cili kërkon ndryshime më urgjente dhe më radikale cilësore dhe sasiore”¹³.

¹⁰ Sharka, Edmond, *Medresetë në trojet shqiptare gjatë sundimit osman*, Gjurma, nr.01, Kumanovë, maj, 2015, f.54.

¹¹ Dr.K.Ajram, *Çfarë mësohet e ç'duhet mësuar*, Argumenti, prill 2006, viti V, nr.4, f.26.

¹² Argumenti, korrik 2005, viti IV, nr.7, *Origjina islame shkencës moderne*, f.27.

¹³ Izetbegoviq, Alija, *Deklarata islame*, Mendimi, Prishtinë, 1999, ff.42-43.

8. Nga shekullarizimi drejt islamizimit të dijeve

Përderisa në shkollat laike synohet shekullarizimi i diturisë, në medrese duhet të synohet islamizimi i saj. Pra detyra e medreseve dhe medresantit është që të thellohet në dijet empirike si në shkencat natyrore, ashtu edhe në ato shoqërore. Epërsia e tij si kërkues i dijes, është se ato e afrojnë edhe më shumë drejt Zotit dhe ia thellojnë edhe më tepër besimin që e ka në Të, për dallim nga ai që i mëson ato si robot mekanikisht, pa u thelluar shpirtërisht e në meditim rreth tyre.

Conclusion

The fact that madrasa diplomas are not accepted by state institutions, namely the Ministry of Education and Science, should be a concern for everyone, especially for those who run madrasas. Every effort should be made to eliminate this problem as soon as possible because the damage is great and long-term. Coordination is needed to look for the causes and reasons and what is required to be met. Also, the madrasa management should do everything possible not only to increase the quality of education in the madrasa, but also to prove this through the activation of students. While madrasa students are not serious competitors to students in other high schools, it is unlikely that the opinion on their level of education can be changed. A lot of work is required because otherwise, the madrasa risks becoming weightless, and students in the future may be reluctant to express their interest in enrolling.

Recensentë:

assoc. prof.dr. Enver Abdullahi

assoc. prof.dr. Naser Ramadani

Referenca:

1. Nesimi, Qani, *Medreseja Isa Beu si rivendosjen e traditës arsimore institucionale islame*, Hëna e Re, viti XXX, nr.314, Shkup, nëntor 2017
2. Faruki, Ismail, R., *Islamizimi i diturisë*, Mehmed Akif Ersoji, Shkup, 1992
3. Nasr, Sejjid, H., *Arsimi modern, historia, teoritë dhe filozofitë e tij*, Logos, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2011

4. Daliu, Ibrahim, Hafëz, *Vlerësimi i diturisë sipas fesë islame*, DI-Ditura Islame, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, viti XXIV, nr.8, gusht 2015
5. Mewdudi, *Studentët muslimanë*, LRI, Shkup, 1991
6. Golshani, Mehdi, *Filozofia e shkencës: një perspektivë kuratore*, revista 'Mejdani', viti II, nr. 6, prill-qershor 2018, Gnosa, Tetovë
7. Kamberi, Bedri, [Dr.chem. sci. profesor i UP dhe UT], *Zoti e bekoftë rininë tonë shkollore*, Argumenti, viti I, nr.6, 2002
8. Tahhan, Mustafa, M., *Udhëzues për veprimtari studentore*, Furkan, Shkup, 2005
9. Sharka, Edmond, *Medresetë në trojet shqiptare gjatë sundimit osman*, Gjurma, nr.01, Kumanovë, maj, 2015
10. Dr.K.Ajram, *Çfarë mësohet e ç'duhet mësuar*, Argumenti, prill 2006, viti V, nr.4
11. Revista 'Argumenti', korrik 2005, viti IV, nr.7, *Origjina islame shkencës moderne*
12. Izetbegović, Alija, *Deklarata islame*, Mendimi, Prishtinë, 1999